

Të nderuar,

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor fillon me realizimin e projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, i cili përfshin edhe organizimin e Forumeve rajonale në bashkësi, me qëllim që të përforcohet pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe rajonal, të përmirësohen partneritetet mes subjekteve rajonale dhe lokale dhe të gjenden zgjidhje më efikase për problemet me interes për të gjithë rajonin.

Projekti është i përkrahur nga Qeveria e konfederatës Zvicerane përmes Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Maqedonisë/Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) dhe Ministrisë së vetëqeverisjes lokale, dhe do ta implementojë Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në bashkëpunim me komunat dhe palët e tjera të prekura nga rajoni.

Forumet rajonale përfshijnë 4 (katër) sesione, nga të cilat 3 (tre) do të realizohen në muajin shkurt dhe në to do të elaborohen problemet më prioritare të bashkësisë në sferat tematike në vijim: **Infrastruktura turistike, Mbrojtja e ambientit jetësor, Infrastruktura e biznesit dhe Inkluzioni social**. Pastaj do të vijojë procesi i zhvillimit të projekt ideve dhe ofrimit të zgjidhjeve të mundëshme, në bazë të cilës do të përgatiten pesë koncepte projektuese, nga të cilat tre projekt koncepte që janë më lartë të ranguara nga forumet rajonale për aplikim, do të aprovohen në seancën e Këshillit për zhvillim të rajonit planor JUGPERËNDIMOR. Për realizimin e projektit të përzgjedhur nga ana e Komisionit për evaluim, mund të fitohen 112.000 franga zvicerane. Projekti duhet të jetë në një nga sferat tematike të lartpërmendura, duhet të përmbajë komponentë infrastrukturore, dhe i njëjti duhet të realizohet deri në fillim të këtij viti.

Me qëllim të zbatimit me sukses të gjithë procesit, Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor **Ju fton të merrni pjesë aktive në sesionin e dytë të forumit, e cila do të mbahet në datë 20.02.2019 (e mërkurë), në Hotel Drim-Strugë, me fillim në ora 11.00.**

Ju lutemi pjesëmarrjen Tuaj ta konfirmoni përmes postës elektronike në adresën vijuese: a.vlashi@southwestregion.mk, ose në telefonin celular: 072 316 882 deri në datë 18.02.2019.

Me respekt,

Qendra për zhvillim të rajonit
planor JUGPERËNDIMOR

Udhëheqës,
M-r Mirjana Lozanoska

Strugë, 14/02/2019

AGJENDA

Projekti “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”
Sesioni i dytë në kuadër të programit “Forumet rajonale në bashkësi” në rajonin planor

Jugperëndimor

Moderator: Sara Osmani

Hotel Drim, salla Piano, Strugë

Data 20.02.2019

10.30 -11:00	Ardhja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve
11:00 -11:05	Miratimi i procesverbalit nga sesioni i parë
11:05 -11:15	Prezantimi i qëllimeve të sesionit dhe vlerësimi i sesionit të mëparshëm
11:15-12:45	<p>Pasqyrimi i sesionit të mëparshëm dhe punimeve mes sesioneve</p> <p>Prezantimi i punës nga grupet punuese</p> <p>Koncepti 1 : Selektimi i mbeturinave në RPJP</p> <p>Diskutim në lidhje me konceptin dhe miratim nga ana e forumit</p> <p>Koncepti 2 : Përshtatja e objekteve publike me energji efikase në RPJP</p> <p>Diskutim në lidhje me konceptin dhe miratim nga ana e forumit</p> <p>Koncepti 3: Qasje alternative për personat me aftësi të kufizuara</p> <p>Diskutim në lidhje me konceptin dhe miratim nga ana e forumit</p> <p>Koncepti 4: Mapimi i vendeve dhe lokaliteteve turistike</p> <p>Diskutim në lidhje me konceptin dhe miratim nga ana e forumit</p> <p>Koncepti 5 : Rregullimi i lumit Treska</p> <p>Diskutim në lidhje me konceptin dhe miratim nga ana e forumit</p>
12.45– 13.00	Kafe pauzë
13:00-13:30	Informacion: Kush mund të jetë bartës i projekti rregullat për përzgjedhjen e projektit
13:30-14:00	Vlerësimi i sesionit të forumit
14.00	Koktel